



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor




**Instituti për Planifikim Hapësinor**

H u l u m t i m

**“Rritja e zonave urbane në Komunitat e Kosovës”**

Nëntor, 2018



## Hyrje

Në Kosovë zonat urbane ndër vite janë rritur në vazhdimësi, disa më shumë e disa më pak dhe në varësi të periudhës dhe faktorëve të ndryshëm kohor. Rritja më e madh ka ndodh në qendrat (qytetet) e mëdha siç janë: Prishtina, Ferizaj, Gjilan, Mitrovica, Peja, Gjakova dhe Prizreni, të cilat me normat teknike në fuqi janë të definuara si qendra rajonale. Sipas hulumtimit, në përgjithësi zgjerimi i zonave urbane është bërë në drejtim të korridoreve të transportit, siç janë: rrugët nacionale, regjionale por edhe në drejtim të disa rrugëve lokale, sidomos në rastet kur vendbanimet rurale kanë qenë shumë afër qyteteve të cilat pastaj, me kalimin e kohës janë bashkuar me qendrën urbane. Raste të tilla janë të njohura në Kosovë, siç është rasti me vendbanimet periferike të Prishtinës (Hajvali, Çagllavicë). Rast i ngjashëm është edhe bashkimi i fshatit Uglarë me qytetin e Fushë Kosovës. Përveç rasteve kur vendbanimet rurale, ose fshatrat përmes zgjerimit urban janë bashkuar qyteteve, janë të njohura edhe rastet kur dy qytete përmes rritjes fizike hapësinore bashkohen, siç është rasti i Prishtinës me Fushë Kosovën.

Rritja apo zgjerimi urban po vazhdon edhe sot, por deri më tash asnjëherë nuk është matur niveli i kësaj rritjeje dhe nuk është përcaktuar trendi i zhvillimit të këtij fenomeni, me ndikim të madh në përcaktimin e zhvillimit të ardhshëm hapësinor. Me qëllim të nxjerrjes në pah të disa informatave bazike për këtë çështje, Instituti për Planifikim Hapësinor përmes kapaciteteve të sajë ka zhvilluar një hulumtim, i cili ka dhënë disa informata preliminare shumë të nevojshme, si për nivelin qendrorë ashtu edhe për nivelin lokal.

Analiza ka pas për qëllim hulumtimin e rritjes urbane në tri etapa kohore, ashtu që të prodhohen rezultate që do të mund të krahasohen dhe të cilat do të mundësonin edhe nxjerrjen e trendit të rritjes apo zgjerimit urban të zonave urbane në Kosovë. Objekt studimi kanë qenë të gjitha qendrat komunale, të cilat për neve janë të njohura edhe si zona urbane. Fillimisht janë hulumtuar zonat urbane të vitit 2001, ku përmes ortofotove është bërë vijëzimi dhe matja e të gjitha zonave urbane për këtë vit, pastaj parim i njëjtë është përdor edhe për vitin 2012. Meqenëse momentalisht Kosova nuk posedon ortofoto të vitit 2018, si burim alternativ kemi përdorur imazhet satelitore të ofruara nga Google Earth.

Gjatë matjes dhe vijëzimit është adaptuar metodologjia e cila ka për qëllim vijëzimin dhe matjen vetëm të strukturës urbane kontinuele, e cila nga qendra në drejtim të periferisë nuk ka ndonjë shkëputje të theksuar që zakonisht ndodhë përmes përmbajtjeve të tokës bujqësore, pyjore dhe përmbajtjeve tjera. Në shumë raste, përveç tokës bujqësore dhe pyjore, si kufi përcaktues i zonës urbane është marr rruga, lumi apo ndonjë strukturë tjetër gjeografik.

Pas matjes së plotë të zgjerimit të zonave urbane për të tri periudhat, është bërë analiza dhe si përfundim kemi rezultatet në vijim:

Rritja e zonave urbane në Kosovë 2000-2018:


- **0.9 %** **10.000** ha në vitin 2000
- **1.5 %** **16.000** ha në vitin 2018, prej të cilave:
- **50 %** **5.000** ha janë shtuar në periudhën 2000-2012;
- **7 %** **1.000** ha janë shtuar në periudhën 2012-2018; që në total:
- **57 %** **6.000** ha janë shtuar në periudhën 2000-2018;
- Rritja e zonave urbane kryesisht në tokë bujqësore;
- Sipas rritjes në periudhën e dytë (12-18) mund të konstatohet se trendi i rritjes është në rënie!!!;

Edhe përkundër punës profesionale të realizuar nga zyrtarë kompetent në IPH, rekomandimi ynë është që, rezultatet në fjalë të shërbejnë si orientim dhe si element me rëndësi për të vendosur zhvillimin e ardhshëm hapësinor të komunës përkatëse.

Në vazhdim të dokumentit, është prezantuar analiza dhe rezultatet për të gjitha zonat urbane të Kosovës veç e veç.

## 1. Komuna e Junikut

Komuna e Junikut ka një sipërfaqe prej 7776 ha. <sup>1</sup>Numri i banorëve i Komunës së Junikut është rreth 6000 banorë dhe është në kategorinë e <sup>2</sup>Vendbanimit shumë të vogël urban (5000 - 10000 banorë).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Junikut


- Në vitin 2000 ZU e Junikut ka pas një sipërfaqe prej 58ha;
- Në vitin 2012 ZU e Junikut ka rreth 139ha ose afërsisht për 139% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Junikut ka një sipërfaqe prej 210ha ose 51% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me theks të veçantë në pjesën veri-lindore të saj;
- Toka bujqësore është toka më e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është i tipit të ulët i shtrirë përreth bërthamës së disa lagjeve të Junikut duke e përcjellë infrastrukturën ekzistuese rrugore.

<sup>1</sup> Burimi i informatave: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>2</sup> Burimi i informatave: Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor

## 2. Komuna e Deçanit

Komuna e Deçanit ka një sipërfaqe prej 29.397 ha.<sup>3</sup> Në Komunën e Deçanit jetojnë rreth 40.000 banorë dhe sipas normave teknike kjo komunë hynë në kategorinë e <sup>4</sup>Vendbanimit të mesëm të vogël urban.



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Deçanit


- Në vitin 2000 ZU e Deçanit ka pas një sipërfaqe prej 150ha;
- Në vitin 2012 ZU e Deçanit ka rreth 203ha ose afërsisht për 35.3% më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Deçanit ka një sipërfaqe prej 238ha, ose 17% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me theks të veçantë në pjesën veri-perëndimore të saj;
- Toka bujqësore është toka më e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual, me etazhitet të ulët, i shtrirë përgjatë rrugëve që kalojnë nëpër ZU.

<sup>3</sup> Burimi i informatave: Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>4</sup> Burimi i informatave: Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor

### 3. Komuna e Gjakovës

Komuna e Gjakovës ka një sipërfaqe prej 58.662 ha. Numri i banorëve i Komunës së Gjakovës është rreth 94.556 banorë<sup>5</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>6</sup> (Qendër rajonale e Dukagjinit Qendror<sup>7</sup>).



#### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Gjakovës

- Në vitin 2000 ZU e Gjakovës ka pas një sipërfaqe prej 762ha;
- Në vitin 2012 ZU e Gjakovës ka rreth 833ha ose afërsisht për 9.3% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Gjakovës ka një sipërfaqe prej 984ha, ose 18% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje relativisht të vogël;
- Toka bujqësore është toka më e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual, me etazhitet të ulët, i shtrirë përgjatë rrugëve ekzistuese dhe rrjedhave lumore që kalojnë në ZU.


<sup>5</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>6</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>7</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.294

## 4. Komuna e Pejës

Komuna e Pejës ka një sipërfaqe prej 60.258 ha. Numri i banorëve i Komunës së Pejës është rreth 96.450 banorë<sup>8</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>9</sup> (Qendër rajonale e Dukagjinit Verior<sup>10</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Pejës

- Në vitin 2000 ZU e Pejës ka pas një sipërfaqe prej 986ha;
- Në vitin 2012 ZU e Pejës ka rreth 1.217ha ose afërsisht për 23.4% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Pejës ka një sipërfaqe prej 1.238ha, ose 2% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën veri-lindore të ZU-së;
- Toka bujqësore është toka më e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual, me etazhitet të ulët, i shtrirë përgjatë rrugëve ekzistuese.


<sup>8</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>9</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>10</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.289

## 5. Komuna e Istogut

Komuna e Istogut ka një sipërfaqe prej 45.436 ha. Numri i banorëve i Komunës së Istogut është rreth 39.289 banorë<sup>11</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të vogël urban<sup>12</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>13</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Istogut

- Në vitin 2000 ZU e Istogut ka pas një sipërfaqe prej 144ha;
- Në vitin 2012 ZU e Istogut ka rreth 176ha ose afërsisht për 22.2% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Istogut ka një sipërfaqe prej 196ha, ose 11.4% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën lindore dhe jugore të ZU-së;
- Toka bujqësore është toka më e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual, me etazhitet të ulët, i shtrirë përgjatë rrugëve ekzistuese rajonale që shtrihen kah pjesa lindore dhe ajo jugore e ZU-së.


<sup>11</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>12</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>13</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.303

## 6. Komuna e Klinës

Komuna e Klinës ka një sipërfaqe prej 30.902 ha. Numri i banorëve i Komunës së Klinës është rreth 38.496 banorë<sup>14</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të vogël urban<sup>15</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>16</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Klinës

- Në vitin 2000 ZU e Klinës ka pas një sipërfaqe prej 156ha;
- Në vitin 2012 ZU e Klinës ka rreth 259ha ose afërsisht për 66% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Klinës ka një sipërfaqe prej 281ha, ose 8.5% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën veriore dhe jugore të ZU-së;
- Toka bujqësore është toka më e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual, me etazhitet të ulët, i shtrirë përgjatë rrugëve ekzistuese rajonale që shtrihen kah pjesa veriore, jugore dhe lindore e ZU-së.

<sup>14</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011


<sup>15</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>16</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.303



## 7. Komuna e Malishevës

Komuna e Malishevës ka një sipërfaqe prej 30.642 ha. Numri i banorëve i Komunës së Malishevës është rreth 54.613 banorë<sup>17</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>18</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>19</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Malishevës

- Në vitin 2000 ZU e Malishevës ka pas një sipërfaqe prej 37ha;
- Në vitin 2012 ZU e Malishevës ka rreth 102ha ose afërsisht për 175% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Malishevës ka një sipërfaqe prej 105ha, ose 3% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën jugore dhe veri-perëndimore të ZU-së;
- Toka bujqësore është toka më e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual, me etazhitet të ulët, i shtrirë përgjatë rrugëve ekzistuese rajonale të ZU-së.


<sup>17</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>18</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>19</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.306

## 8. Komuna e Suharekës

Komuna e Suharekës ka një sipërfaqe prej 36.104 ha. Numri i banorëve i Komunës së Suharekës është rreth 59.722 banorë<sup>20</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>21</sup> (Qendër komunale më pak e zhvilluar<sup>22</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Suharekës

- Në vitin 2000 ZU e Suharekës ka pas një sipërfaqe prej 186ha;
- Në vitin 2012 ZU e Suharekës ka rreth 235ha ose afërsisht për 26% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Suharekës ka një sipërfaqe prej 252ha, ose 7% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Lindje -Perëndim të ZU-së;
- Toka bujqësore është toka më e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual dhe me etazhitet të ulët.


<sup>20</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>21</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>22</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.300

## 9. Komuna e Mamushës

Komuna e Mamushës ka një sipërfaqe prej 1.094 ha. Numri i banorëve i Komunës së Mamushës është rreth 5.507 banorë<sup>23</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit rural i madh<sup>24</sup> (Qendër sekondare<sup>25</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Mamushës

- Në vitin 2000 ZU e Mamushës ka pas një sipërfaqe prej 54ha;
- Në vitin 2012 ZU e Mamushës ka rreth 73ha ose afërsisht për 35% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Mamushës ka një sipërfaqe prej 80ha, ose 8.2% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veri- Jug të ZU-së;
- Toka bujqësore është toka më e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual, me etazhitet të ulët, i shtrirë përgjatë rrugës ekzistuese rajonale të ZU-së.


<sup>23</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>24</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>25</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.307

## 10. Komuna e Rahovecit

Komuna e Rahovecit ka një sipërfaqe prej 27.590 ha. Numri i banorëve i Komunës së Rahovecit është rreth 56.208 banorë<sup>26</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>27</sup> (Qendër e zhvilluar komunale<sup>28</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Rahovecit

- Në vitin 2000 ZU e Rahovecit ka pas një sipërfaqe prej 213ha;
- Në vitin 2012 ZU e Rahovecit ka rreth 305ha ose afërsisht për 43% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Rahovecit ka një sipërfaqe prej 311ha, ose 2% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë kryesisht në pjesën Perëndimore dhe Jugore të ZU-së;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët e zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme), me etazhitet të ulët, i shtrirë përgjatë rrugës ekzistuese rajonale të ZU-së.


<sup>26</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>27</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>28</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.298

## 11. Komuna e Dragashit

Komuna e Dragashit ka një sipërfaqe prej 43.385 ha. Numri i banorëve i Komunës së Dragashit është rreth 33.997 banorë<sup>29</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të vogël urban<sup>30</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>31</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Dragashit

- Në vitin 2000 ZU e Dragashit ka pas një sipërfaqe prej 68ha;
- Në vitin 2012 ZU e Dragashit ka rreth 88ha ose afërsisht për 30% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Dragashit ka një sipërfaqe prej 91ha, ose 3.5% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë kryesisht në pjesën Perëndimore dhe atë Qendrore të ZU-së;
- Në pjesën Perëndimore kemi tokën më të rrafshët, ndërsa ajo qendrore është kryesisht tokë kodrinore, që është e preferuar për zhvillim;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual, me etazhitet të ulët, i shtrirë në afërsi të rrugëve regionale R113 dhe R114 dhe rrugëve lokale që lidhen me vendbanimet Sainovcë dhe Lubovishtë të ZU-së.


<sup>29</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>30</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>31</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.305

## 12. Komuna e Prizrenit

Komuna e Prizrenit ka një sipërfaqe prej 62.686 ha. Numri i banorëve i Komunës së Prizrenit është rreth 178.000 banorë<sup>32</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të madh urban<sup>33</sup> (Qendër rajonale e Dukagjinit Jugor<sup>34</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Prizrenit

- Në vitin 2000 ZU e Prizrenit ka pas një sipërfaqe prej 1.002ha;
- Në vitin 2012 ZU e Prizrenit ka rreth 1.577ha ose afërsisht për 57% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Prizrenit ka një sipërfaqe prej 1.600ha, ose 1.5% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veri- Perëndim të ZU-së;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore e zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme), me etazhitet të ulët, e bashkuar me VB Dushanovë, që shtrihet në pjesën Veri-Perëndimore të të ZU-së.


<sup>32</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>33</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>34</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.286

## 13. Komuna e Kamenicës

Komuna e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 41.661 ha. Numri i banorëve i Komunës së Kamenicës është rreth 36.085 banorë<sup>35</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të vogël urban<sup>36</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>37</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Kamenicës

- Në vitin 2000 ZU e Kamenicës ka pas një sipërfaqe prej 166ha;
- Në vitin 2012 ZU e Kamenicës ka rreth 331ha ose afërsisht për 99% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Kamenicës ka një sipërfaqe prej 350ha, ose 5.7% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veriore dhe Jugore të ZU-së, ku në veri përgjatë rrugës ekzistuese (pjesa kodrinore), në pjesën qendrore përgjatë rrugës regjionale R 123 dhe në jug përgjatë rrugës ekzistuese;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore e zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme), me etazhitet të ulët, e bashkuar me VB Berivojcë, që shtrihet në pjesën Lindore të ZU-së.


<sup>35</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>36</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>37</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.305

## 14. Komuna e Ranillugut

Komuna e Ranillugut ka një sipërfaqe prej 7.762 ha. Numri i banorëve i Komunës së Ranillugut është rreth 3.866 banorë<sup>38</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit rural të madh<sup>39</sup> (Qendër lokale<sup>40</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Ranillugut

- Në vitin 2000 ZU e Ranillugut ka pas një sipërfaqe prej 51.6 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Ranillugut ka rreth 59.2 ha ose afërsisht për 14.7 % më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Ranillugut ka një sipërfaqe prej 60 ha, ose 1.4 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët me një rritje të lehtë, me një rritje në pjesën veriore të ZU-së, përgjatë rrugës lokale që kalon nëpër ZU;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa kodrinore e zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi me etazhitet të ulët dhe përveç Ranillugut si vendbanim është bashkuar edhe VB Glllogoc, që gjendet në pjesën jugore të zonës.

<sup>38</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011


<sup>39</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>40</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.308



## 15. Komuna e Gjilanit

Komuna e Gjilanit ka një sipërfaqe prej 39.184 ha. Numri i banorëve i Komunës së Gjilanit është rreth 90.178 banorë<sup>41</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>42</sup> (Qendër rajonale e Anamoravës<sup>43</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Gjilanit

- Në vitin 2000 ZU ka qenë në territorin e komunës së Gjilan si dhe një pjesë e vogël në territorin e komunës së Novobërdës me sipërfaqe 643.21ha dhe sipërfaqja e territorit të komunës së Gjilanit me sipërfaqe prej 636.03ha;
- Në vitin 2012 ZU e Gjilanit ka rritje në të gjitha anët e zonës dhe po ashtu në pjesën veriore të saj pra, në territorin e komunës së Novobërdës me sipërfaqe prej 1165.35 ha dhe të territorit të Gjilanit me 1102.13 ha;
- Në vitin 2018 ZU e Gjilanit ka një rritje më të vogël se në 2012, ku territori i ZU-së është 1280.30 ha dhe ZU e territorit të Gjilanit ka 1212.14 ha;
- Sipas hartës konstatohet se kaha e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veriore dhe Jugore të ZU-së, përgjatë rrugëve që kalojnë në Zonë;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore e zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme), me etazhitet të ulët, me gurëthyes masiv, me objekte tregtare , afariste dhe sportive.


<sup>41</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>42</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>43</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.293

## 16. Komuna e Kllokotit

Komuna e Kllokotit ka një sipërfaqe prej 2.339 ha. Numri i banorëve i Komunës së Kllokotit është rreth 2.556 banorë<sup>44</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit rural të madh<sup>45</sup> (Qendër sekondare<sup>46</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Kllokotit

- Në vitin 2000 ZU e Kllokotit ka pas një sipërfaqe prej 49.2 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Kllokotit ka rreth 64 ha ose afërsisht për 30 % më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Kllokotit ka një sipërfaqe prej 67 ha, ose 4.7 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje më të theksuar në pjesën veri-lindore, duke e përcjellë rrugën nacionale M25.3 të saj.
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore e zonës në fjalë;
- Ndërtimi dhe rritja e ZU-së kryesisht është me depo të materialeve dhe atyre ushqimore.


<sup>44</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>45</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>46</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.307

## 17. Komuna e Vitisë

Komuna e Vitisë ka një sipërfaqe prej 26.969 ha. Numri i banorëve i Komunës së Prizrenit është rreth 46.987 banorë<sup>47</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të vogël urban<sup>48</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>49</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Vitisë

- Në vitin 2000 ZU e Vitisë ka pas një sipërfaqe prej 111 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Vitisë ka rreth 194 ha ose afërsisht për 75 % më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Vitisë ka një sipërfaqe prej 250 ha, ose 29 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se krahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veriore të saj, nga të dy anët e lumit Gadime si dhe përgjatë rrugëve regjionale R122 dhe R211;
- Rritja e ZU-së është bërë në pjesët e ulta, me tokë bujqësore të zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme), me etazhitet të ulët, si dhe disa objekte hotelere dhe fusha të hapura sportive.


<sup>47</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>48</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>49</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.305

## 18. Komuna e Shtimes

Komuna e Shtimes ka një sipërfaqe prej 13.442 ha. Numri i banorëve i Komunës së Shtimes është rreth 27.324 banorë<sup>50</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të vogël urban<sup>51</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>52</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Shtimes

- Në vitin 2000 ZU e Shtimes ka pas një sipërfaqe prej 112 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Shtimes ka rreth 168 ha ose afërsisht për 50 % më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Shtimes ka një sipërfaqe prej 213 ha, ose 27 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se koha e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Jugore të saj, rrugës nacionale M25 dhe disa rrugëve urbane e lokale;
- Rritja e ZU-së është bërë në pjesët e ulta dhe ato kodrinore të zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme, shitore, restorante, motele), me etazhitet të ulët.


<sup>50</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>51</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>52</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.303

## 19. Komuna e Graçanicës

Komuna e Graçanicës ka një sipërfaqe prej 12.241 ha. Numri i banorëve i Komunës së Graçanicës është rreth 10.675 banorë<sup>53</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të vogël urban<sup>54</sup> (Qendër sekondare<sup>55</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Graçanicës

- Në vitin 2000 ZU e Graçanicës ka pas një sipërfaqe prej 122 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Graçanicës ka rreth 154 ha ose afërsisht për 26 % më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Graçanicës ka një sipërfaqe prej 169 ha, ose 9.8 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, përgjatë rrugës nacionale M25.2;
- Rritja e ZU-së është bërë në pjesët e ulta me tokë bujqësore të zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme, shitore, restorante, motele), me etazhitet të ulët dhe fushë të sportive.


<sup>53</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>54</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>55</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.307

## 20. Komuna e Hanit të Elezit

Komuna e Hanit të Elezit ka një sipërfaqe prej 8.311 ha. Numri i banorëve i Komunës së Hanit të Elezit është rreth 9.403 banorë<sup>56</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit shumë të vogël urban<sup>57</sup> (Qendër sekondare<sup>58</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Hanit të Elezit

- Në vitin 2000 ZU e Hanit të Elezit ka pas një sipërfaqe prej 70 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Hanit të Elezit ka rreth 75 ha ose afërsisht për 7 % më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Hanit të Elezit ka një sipërfaqe prej 79 ha, ose 5 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është shumë e vogël duke e krahasuar me vitin 2000, rritja është bërë në afërsi të rrugës nacionale M2/01;
- Rritja e ZU-së është bërë në pjesët e ulta të zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme, shitore), me etazhitet të ulët.


<sup>56</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>57</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>58</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.307

## 21. Komuna e Shtërpçës

Komuna e Shtërpçës ka një sipërfaqe prej 24.770 ha. Numri i banorëve i Komunës së Shtërpçës është rreth 6.949 banorë<sup>59</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit shumë të vogël urban<sup>60</sup> (Qendër sekondare<sup>61</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Shtërpçës

- Në vitin 2000 ZU e Shtërpçës ka pas një sipërfaqe prej 73 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Shtërpçës ka rreth 78 ha ose afërsisht për 7 % më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Shtërpçës ka një sipërfaqe prej 79 ha, ose 1.2 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kaha e rritjes është shumë e vogël duke e krahasuar me vitin 2000, ZU e Shtërpçës është e bashkuar me VB Berofcë;
- Rritja e ZU-së është bërë në pjesët e ulta me tokë bujqësore të zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi me etazhitet të ulët.


<sup>59</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>60</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>61</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.307

## 22. Komuna e Kaçanikut

Komuna e Kaçanikut ka një sipërfaqe prej 21.128 ha. Numri i banorëve i Komunës së Kaçanikut është rreth 33.409 banorë<sup>62</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të vogël urban<sup>63</sup> (Qendër komunale më pak e zhvilluar<sup>64</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Kaçanikut

- Në vitin 2000 ZU e Kaçanikut ka pas një sipërfaqe prej 123 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Kaçanikut ka rreth 162 ha ose afërsisht për 32 % më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Kaçanikut ka një sipërfaqe prej 163 ha, ose 0.6 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veri-Perëndimore të saj, përgjatë lumenjve Nerodimka dhe Lepenc si dhe rrugës nacionale M2/01 dhe zona në fjalë bashkohet edhe me VB Bob;
- Rritja e ZU-së është bërë në pjesët e ulta të zonës;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme), me etazhitet të ulët.

<sup>62</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011


<sup>63</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>64</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.301



## 23. Komuna e Ferizajt

Komuna e Ferizajt ka një sipërfaqe prej 34.461 ha. Numri i banorëve i Komunës së Ferizajt është rreth 108.610 banorë<sup>65</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të madh urban<sup>66</sup> (Qendër rajonale e Kosovës Jug-Lindore<sup>67</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Ferizajt

- Në vitin 2000 ZU e Ferizajt ka pas një sipërfaqe prej 748ha;
- Në vitin 2012 ZU e Ferizajt ka rreth 1.018ha ose afërsisht për 36% më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Ferizajt ka një sipërfaqe prej 1.118ha, ose 10% më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Lindore të ZU-së;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore e zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme, shitore, terrene sportive të hapura, restorante, motele etj), me etazhitet të ulët, dhe të bashkuara me VB Seret e Talinoc.


<sup>65</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>66</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>67</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.295

## 24. Komuna e Prishtinës

Komuna e Prishtinës ka një sipërfaqe prej 52.315 ha. Numri i banorëve i Komunës së Prishtinës është rreth 198.897 banorë<sup>68</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të madh urban<sup>69</sup> (Qendër makroregjionale - Kryeqendër e Kosovës<sup>70</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Prishtinës

- Në vitin 2000 ZU e Prishtinës ka pas një sipërfaqe prej 1.492.88ha;
- Në vitin 2012 ZU e Prishtinës ka rreth 2.177.29ha ose afërsisht për 46% më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Prishtinës ka pasë një rritje përgjatë rrugës nacionale M9, ku edhe bashkohet me ZU të Fushë Kosovës si dhe një pjesë e vogël del edhe në territorin e komunës së Graçanicës dhe ka një sipërfaqe prej 2.894ha, ndërkaq ZU e territorit të komunës së Prishtinës është 2.333ha;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Jug-Lindore të ZU-së, duke u bashkuar me VB Matičan dhe Sofali;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, por kah pjesa Veriore është zgjeruar përgjatë rrugës nacionale M25 duke iu përshtatur konfigurimit të terrenit;
- Zgjerimi i ZU-së kah VB Matičan është bërë me ndërtime të reja dhe kryesisht me banim kolektiv me etazhite të lartë - me ndërtesa banimi me shumë njësi, ndërsa etazhet e poshtme janë me destinim si (lokale afriste, tregtare, restorante dhe me destinime tjera);
- Pjesa lindore e ZU-së është zgjeruar me ndërtime të banimit individual - shtëpi banimi me etazhite të ulët. Po ashtu edhe zgjerimi kah ana veriore është i zgjeruar me shtëpi banimi me etazhite të ulët por të kombinuar apo mix (me shitore, depo të ndryshme, motele etj.);

<sup>68</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011


<sup>69</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>70</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.281

- Pjesa Perëndimore e ZU-së është lagjja Arbëria, e cila është zgjeruar kryesisht me banim kolektiv - ndërtesa banimi me shumë njësi dhe e kombinuar në etazhet e poshtme me lokale tregtare, afariste, shëndetësore dhe me objektin e komunës së Prishtinës dhe Ambasadës amerikane; dhe
- Pjesa jugore e ZU-së është zgjeruar përgjatë rrugës nacionale M9 që lidhet me F. Kosove, me objekte industriale, depo të ndryshme, objekte afariste, tregtare dhe objekte të banimit kolektiv me etazhitet të lartë - ndërtesa të banimit me shumë njësi.

## 25. Komuna e Fushë Kosovës

Komuna e Fushë Kosovës ka një sipërfaqe prej 8.409 ha. Numri i banorëve i Komunës së F. Kosovës është rreth 34.827 banorë<sup>71</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të vogël urban<sup>72</sup> (Qendër komunale më pak e zhvilluar<sup>73</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Fushë Kosovës

- Në vitin 2000 ZU e F. Kosovës është përfshi edhe nga një pjesë e territorit të komunës së Graçanicës, duke i'u bashkangjitur edhe VB Bresje e komunës së F. Kosovës dhe VB Uglarë e komunës së Graçanicës, me sipërfaqe prej 459 ha. Ndërkaq sipërfaqja e ZU-së së territorit të komunës së F. Kosovës ka qenë 362.8;
- Në vitin 2012 ZU e F. Kosovës me komunat tjera ka pasë sipërfaqe prej 557.42, ndërkaq ZU e territorit të F. Kosovës ka qenë 441ha dhe është zgjeruar kryesisht në anën veriore të saj me ndërtime të banimit individual me etazhitet të ulët dhe me objekte tregtare dhe depo të materialeve të ndryshme. Po ashtu zgjerimi është bërë edhe në anën Veri-Lindorë të ZU-së përgjatë rrugës nacionale M9, rruga F. Kosovë-Prishtinë, kryesisht me objekte industriale dhe tregtare;
- Në vitin 2018 Zu e F. Kosovës (Prishtinës dhe Graçanicës) ka një sipërfaqe prej 2894.38ha dhe ZU e territorit të F. Kosovës ka sipërfaqe prej 459.42ha, me një rritje më të ulët dhe atë në anën Jugore të saj përgjatë rrugës nacionale M9, si dhe në Veri-Lindje duke vazhduar në drejtim të Prishtinës (në territorin e komunës së Prishtinës) dhe atë me ndërtesa kolektive me etazhitet të lartë - me ndërtesa banimi me shumë njësi, me objekte tregtare, objekte universitare, me depo të ndryshme etj;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore e zonës në fjalë.


<sup>71</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>72</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>73</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.300

## 26. Komuna e Skenderajt

Komuna e Skenderajt ka një sipërfaqe prej 37.431 ha. Numri i banorëve i Komunës së Skenderajt është rreth 50.858 banorë<sup>74</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>75</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>76</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Skenderajt

- Në vitin 2000 ZU e Skenderajt ka pas një sipërfaqe prej 130 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Skenderajt ka rreth 226 ha ose afërsisht për 74 % më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Skenderajt ka një sipërfaqe prej 266 ha, ose 18 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Jugore dhe Perëndimore të saj, në afërsi të lumit Klina, përgjatë rrugës regjionale R102/04;
- Rritja e ZU-së është bërë në pjesët kodrinore të saj, dhe është bashkuar me VB Klinë e Poshtme;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë me etazhitet të ulët, depo të ndryshme të materialeve ndërtimore, si dhe disa objekte tjera industriale.


<sup>74</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>75</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>76</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.304

## 27. Komuna e Lipjanit

Komuna e Lipjanit ka një sipërfaqe prej 33.841 ha. Numri i banorëve i Komunës së Lipjanit është rreth 57.605 banorë<sup>77</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>78</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>79</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Lipjanit

- Në vitin 2000 ZU e Lipjanit ka pas një sipërfaqe prej 133ha;
- Në vitin 2012 ZU e Lipjanit ka pasë një rritje në anën veriore të saj, përgjatë hekurudhës Prishtinë - Shkup dhe po ashtu zgjerimi i ZU-së ka kaluar edhe në territorin e komunës së Graçanicës me sipërfaqe prej 244.48ha, ndërsa ZU e territorit të Lipjanit me sipërfaqe prej 232.29ha;
- Ndërkaq në vitin 2018 Zu e Lipjanit ka një rritje relativisht të vogël, me theks të veçantë kah pjesa veriore e saj, me sipërfaqe prej 284.06ha, ndërsa ZU e territorit të komunës së Lipjanit ka 271.14ha;
- Rritja e ZU-së është bërë në pjesët e ulta, me tokë bujqësore të zonës në fjalë;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë (depo të ndryshme), me etazhitet të ulët, dhe objekte industriale, objekte hoteliere, restorante etj.


<sup>77</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>78</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>79</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.302

## 28. Komuna e Obiliqit

Komuna e Obiliqit ka një sipërfaqe prej 10.484 ha. Numri i banorëve i Komunës së Obiliqit është rreth 21.549 banorë<sup>80</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të vogël urban<sup>81</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>82</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Obiliqit

- Në vitin 2000 ZU e Obiliqit ka pas një sipërfaqe prej 129 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Obiliqit ka rreth 522 ha ose afërsisht për 304 % më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Obiliqit ka një sipërfaqe prej 537 ha, ose 2.9 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kaha e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veriore dhe Jugore të saj, përgjatë rrugës regjionale R220;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore e zonës në fjalë, dhe është bashkuar me VB Kryshevc;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë me etazhitet të ulët, Zona industriale e Termocentralit, depo të ndryshme të materialeve ndërtimore, objekt arsimor, restorante, motele etj.


<sup>80</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>81</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>82</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.302

## 29. Komuna e Vushtrrisë

Komuna e Vushtrrisë ka një sipërfaqe prej 34.485 ha. Numri i banorëve i Komunës së Vushtrrisë është rreth 69.870 banorë<sup>83</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>84</sup> (Qendër e zhvilluar komunale<sup>85</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Vushtrrisë

- Në vitin 2000 ZU e Vushtrrisë ka pas një sipërfaqe prej 375 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Vushtrrisë ka rreth 566 ha ose afërsisht për 51 % më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Vushtrrisë ka një sipërfaqe prej 609 ha, ose 7.6 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kaha e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veriore të saj, përgjatë rrugës nacionale M2 (Prishtinë - Mitrovicë), kryesisht në anën e djathtë të rrugës;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore, përgjatë lumit Tërstena dhe ZU është bashkuar me VB Begaj;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë me etazhitet të ulët, pompë të benzinës, depo të ndryshme të materialeve ndërtimore, deponi të automjeteve, restorante, shitore, pishinë të hapur etj.

<sup>83</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011


<sup>84</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>85</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.298



## 30. Komuna e Zveçanit

Komuna e Zveçanit ka një sipërfaqe prej 12.301 ha.




### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Zveçanit

- Në vitin 2000 ZU e Zveçanit ka pasë një sipërfaqe prej 60.43 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Zveçanit është rritur për 2.48% apo 61.93 ha;
- Në vitin 2018 ZU e Zveçanit ka sipërfaqe prej 63.64 apo 2.76% më të madhe.
- Rritja e ZU-së është shumë e ulët, me ndërtime kryesisht shtëpi banimi individual mix- tregtarë me etazhitet të ulët, me depo të materialeve ndërtimore.

## 31. Komuna e Podujevës

Komuna e Podujevës ka një sipërfaqe prej 63.259 ha. Numri i banorëve i Komunës së Podujevës është rreth 88.499 banorë<sup>86</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>87</sup> (Qendër e zhvilluar komunale<sup>88</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Podujevës

- Në vitin 2000 ZU e Podujevës ka pas një sipërfaqe prej 399 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Podujevës ka rreth 583 ha ose afërsisht për 46 % më e madhe;
- Në vitin 2018 ZU e Podujevës ka një sipërfaqe prej 660 ha, ose 13 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Jugore të saj të saj, nëpër dy rrugët regjionale (R126 dhe R127) të kryqëzuara në ZU-së;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore, edhe përgjatë lumit Llap, si dhe ZU është bashkuar me VB Mercez;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë me etazhitet të ulët, pompë të benzinës, depo të ndryshme të materialeve ndërtimore, deponi të automjeteve, restorante, shitore etj.


<sup>86</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>87</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>88</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.299

## 32. Komuna e Zubin Potokut

Komuna e Zubin Potokut ka një sipërfaqe prej 33.438 ha.




### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Zubin Potokut

- Në vitin 2000 ZU e Zubin Potokut ka pas një sipërfaqe prej 43 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Zubin Potokut ka rreth 61.5 ha ose afërsisht për 43 % më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Zubin Potoku ka një sipërfaqe prej 70 ha, ose 14 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veriore të saj, përgjatë rrugës nacionale M2;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore, duke iu afuar lumit Ibër;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë me etazhitet të ulët.

### 33. Komuna e Leposaviqit

Komuna e Leposaviqit ka një sipërfaqe prej 53.905 ha.




#### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Leposaviqit

- Në vitin 2000 ZU e Leposaviqit ka pas një sipërfaqe prej 88 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Leposaviqit ka rreth 116 ha ose afërsisht për 32 % më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Leposaviqit ka një sipërfaqe prej 121 ha, ose 4 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje të theksuar në pjesën Veriore të saj, përgjatë rrugës nacionale M22.3, hekurudhës që kalon dhe në afërsi të lumit Ibër;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët dhe ajo kodrinore dhe kryesisht në afërsi të rrugës;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë me etazhitet të ulët, dhe me depo të materialeve (kryesisht me ato drunore).

## 34. Komuna e Gllgocit

Komuna e Gllgocit ka një sipërfaqe prej 27.569 ha. Numri i banorëve i Komunës së Gllgocit është rreth 58.531<sup>89</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>90</sup> (Qendër e vogël komunale<sup>91</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Gllgocit

- Në vitin 2000 ZU e Gllgocit ka pas një sipërfaqe prej 208 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Gllgocit ka rreth 222 ha ose afërsisht për 6.7 % më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Gllgocit ka një sipërfaqe prej 244.5 ha, ose 10 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje relativisht të ulët, kryesisht në anën Veriore të ZU-së dhe në anën Lindore në afërsi të hekurudhës dhe një rruge lokale si dhe përgjatë rrugës regjionale R102;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore, edhe përgjatë lumit Llap, si dhe ZU është bashkuar me VB Qikatovë e re;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë me etazhitet të ulët, depo të ndryshme të materialeve ndërtimore, deponi të automjeteve, restorante, shitore etj.


<sup>89</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>90</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>91</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.304

## 35. Komuna e Parteshit

Komuna e Parteshit ka një sipërfaqe prej 2.867 ha. Numri i banorëve i Komunës së Parteshit është rreth 1.787<sup>92</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh rural<sup>93</sup> (Qendër sekondare<sup>94</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Parteshit

- Në vitin 2000 ZU e Parteshit ka pas një sipërfaqe prej 44.6 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Parteshit ka rreth 48.5 ha ose afërsisht për 9 % më e madhe;
- Në vitin 2018 Zu e Parteshit ka një sipërfaqe prej 50.4 ha, ose 4 % më e madhe nga matja paraprake;
- Sipas hartës konstatohet se kahja e rritjes është bërë në të gjitha anët, me një rritje relativisht të ulët, kryesisht në anën Lindore të ZU-së;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore;
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix - tregtarë me etazhitet të ulët, depo të ndryshme të materialeve ndërtimore;


<sup>92</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>93</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>94</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.307

## 36. Komuna e Novobërdës

Komuna e Novobërdës ka një sipërfaqe prej 20.398 ha. Numri i banorëve i Komunës së Novobërdës është rreth 6.729 banorë<sup>95</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit shumë të vogël urban<sup>96</sup> (Qendër lokale<sup>97</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Novobërdës

- Në vitin 2000 ZU e Novobërdës ka pasë një sipërfaqe prej 4.15 ha. Sipas hartës konstatohet se nuk kemi rritje të vazhdueshme në kuadër të kësaj zone. Zhvillimet janë të ndara në vendbanimet tjera që janë në afërsi të Novobërdës.


<sup>95</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011

<sup>96</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>97</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.308

## 37. Komuna e Mitrovicës

Komuna e Mitrovicës ka një sipërfaqe prej 33.072 ha. Numri i banorëve i Komunës së Mitrovicës është rreth 71.909 banorë<sup>98</sup> dhe është në kategorinë e Vendbanimit të mesëm të madh urban<sup>99</sup> (Qendër rajonale e Kosovës veriore<sup>100</sup>).



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Mitrovicës

- Në vitin 2000 ZU e Mitrovicës është përfshi edhe me ZU të komunës së Mitrovicës veriore, dhe një pjesë e vogël është shtri edhe në territorin e komunës së Zveçanit. Sipërfaqja e ZU-së (në të tri komunat) ka qenë 918.75 ha, ndërsa sipërfaqja e ZU-së vetëm në territorin e Mitrovicës ka qenë 776.04 ha. Në kuadër të ZU-së kalojnë tre lumenj (Ibri, Lushta dhe Sitnica) si dhe hekurudha Mitrovicë - Shkup;
- Në vitin 2012 ZU e Mitrovicës (e përbashkët me tri komuna) është zgjeruar në të gjitha anët, por me theks në anën Jugore të saj. Sipërfaqja e përbashkët e ZU-së ka qenë 1163.33 ha apo 26.6 % më e madhe, ndërkaq sipërfaqja e ZU-së vetëm për territorin e Mitrovicës ka qenë 1018.52 ha apo 31.2 % më e madhe.
- Në vitin 2018 ZU e Mitrovicës (e përbashkët me tri komuna) është zgjeruar në të gjitha anët, por me theks në anën Jug- Perëndimore të saj, në mes të lumenjve Ibër dhe Lushtë. Sipërfaqja e përbashkët e ZU-së është 1320.93 ha apo 13.5 % më e madhe, ndërkaq sipërfaqja e ZU-së vetëm për territorin e Mitrovicës është 1161.44 ha apo 14 % më e madhe.
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore e zonës në fjalë. Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix- tregtarë me etazhitet të ulët, me depo të materialeve ndërtimore (kryesisht përgjatë rrugëve), ndërtesa të moteleve (bujtina), restorante dhe deponi të automjeteve.

<sup>98</sup> Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), viti 2011


<sup>99</sup> Udhëzimi administrativ MMPH - nr.08/17 për Normat teknike të planifikimit hapësinor, 2017

<sup>100</sup> I.Ramadani, Vendbanimet e Kosovës, Prishtinë, 2016, fq.292



## 38. Komuna e Mitrovicës Veriore

Komuna e Mitrovicës Veriore ka një sipërfaqe prej 546 ha.



### Zhvillimi (rritja) e Zonës urbane të Mitrovicës Veriore

- Në vitin 2000 ZU e Mitrovicës Veriore është përfshi edhe me ZU të komunës së Mitrovicës, dhe një pjesë e vogël është shtri edhe në territorin e komunës së Zveçanit. Sipërfaqja e ZU-së (në të tri komunat) ka qenë 918.75 ha, ndërsa sipërfaqja e ZU-së vetëm në territorin e Mitrovicës V ka qenë 140.46 ha;
- Në vitin 2012 ZU e Mitrovicës Veriore (e përbashkët me tri komuna) është zgjeruar në të gjitha anët, por me theks në anën Jugore të saj. Sipërfaqja e përbashkët e ZU-së ka qenë 1163.33 ha apo 26.6 % më e madhe, ndërsa sipërfaqja e ZU-së vetëm për territorin e Mitrovicës V ka qenë 142.34 ha apo 1.34 % më e madhe, që është një rritje shumë e vogël e saj;
- Në vitin 2018 ZU e Mitrovicës Veriore (e përbashkët me tri komuna) është zgjeruar në të gjitha anët, por me theks në anën Jug- Perëndimore të saj. Sipërfaqja e përbashkët e ZU-së është 1320.93 ha apo 13.5 % më e madhe, ndërsa sipërfaqja e ZU-së vetëm për territorin e Mitrovicës V është 156.85 ha apo 10.2 % më e madhe, e cila është zgjeruar kryesisht në anën veriore të zonës, sidomos në afërsi të hekurudhës (Mitrovicë- Shkup), si dhe një pjesë në perëndim të ZU-së;
- Rritja e ZU-së është bërë kah pjesa e ulët, me tokë bujqësore e zonës në fjalë.
- Ndërtimi kryesisht është me shtëpi banimi individual mix - tregtarë me etazhitet të ulët, me depo të materialeve ndërtimore.



Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor



Instituti për Planifikim Hapësinor

## Hulumtim

### “Rritja e zonave urbane në Komunat e Kosovës”

Grupi i angazhuar:

- Luan **NUSHI** Arkitekt planer – Drejtor në IPH – iniciues i hulumtimit
- Rizah **MURSELI** Gjeograf planer – Udhëheqës i Divizionit të GIS-it në IPH – koordinators i grupit;
- Festa **NIXHA NELA** Arkitekt planere – Zyrtare e lartë për analiza hapësinore – anëtare e grupit;
- Mimoza **KALLABA** Gjeograf planere – Zyrtare për bazën e të dhënave – anëtare e grupit;
- Violeta **BEHRAMI** Studente praktikante – anëtare e grupit.

p.s.

Të gjitha komunat e interesuara me kërkesë formale drejtuar në adresë të Institutit për Planifikim Hapësinor/MMPH, mund të paisen me të gjitha të dhënat digjitale (shape-file) për zonat e tyre urbane.

Nëntor, 2018

